

LIGJ
Nr.9891, datë 20.3.2008

**PËR RATIFIKIMIN E NDRYSHIMIT TË “MARRËVESHJES SË RISHITJES SË
AKSIONEVE TË INSIG SHA-SË NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCIVE, QË VEPRON
NË EMËR TË SHTETIT SHQIPTAR, KORPORATËS FINANCIARE NDËRKOMBËTARE
(IFC) DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM (BERZH)”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet ndryshimi i “Marrëveshjes së rishitjes së aksioneve të INSIG sha-së ndërmjet Ministrisë së Financave, që vepron në emër të shtetit shqiptar, Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC) dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.5676, datë 28.3.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

NDRYSHIMI I DYTË I MARRËVESHJES
SË RISHITJES SË AKSIONEVE NDËRMJET BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM DHE KORPORATËS FINANCIARE NDËRKOMBËTARE DHE MINISTRISË SË
FINANCIVE, QË VEPRON NË EMËR TË SHTETIT SHQIPTAR
Datë 30 janar 2008

Ndryshimi i dytë i Marrëveshjes së Rishitjes së Aksioneve

Ndryshimi i dytë i Marrëveshjes së Rishitjes së Aksioneve (kjo “Marrëveshje e ndryshimit të dytë), datë 30 janar 2008, ndërmjet Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC) dhe Ministrisë së Financave, që vepron në emër të shtetit shqiptar, në pajtim me ligjin nr.8831, datë 22 nëntor 2001, mbi pronësinë shtetërore në shoqëritë tregtare financiare me kapital tërësisht shtetëror, pronar i aksioneve tek Instituti i Sigurimeve sh.a., përfaqësuar nga Ministri i Financave (MF).

Duke pasur parasysh që:

A) Më 28 tetor 2003, EBRD, IFC dhe MF (Palët) përfunduan një Marrëveshje të Blerjes së Aksioneve, (Marrëveshja e Blerjes së Aksioneve), sipas së cilës MF-ja i shiste EBRD-së aksionet e EBRD-së dhe MF-ja i shiste IFC-së aksionet e IFC-së; dhe

B) Sipas termave të Marrëveshjes së Blerjes së Aksioneve, më 28 tetor 2003, Palët përfunduan një Marrëveshje për Rishitjen e Aksioneve (Marrëveshja e Rishitjes së Aksioneve), që parashikon për EBRD-në dhe IFC-në për t’i rishitur aksionet e EBRD-së dhe IFC-së, MF-së, sipas termave dhe kushteve të caktuara në të; dhe

C) Më 10 gusht 2006, Palët e ndryshuan Marrëveshjen e Rishitjes së Aksioneve për të zgatur periudhën e shitjes të përcaktuar në Marrëveshjen e Rishitjes së Aksioneve, me qëllim që t’i lejohet

MF-së një periudhë më e gjatë në të cilën të identifikojë investitorin strategjik të pranueshëm për EBRD-në dhe IFC-në, dhe si pasojë e saj, të shtyjë ndodhinë e ngjarjes së daljes që do t'i lejonte EBRD-së dhe IFC-së të ushtronin të drejtat e tyre për t'i rishitur aksionet e EBRD-së dhe aksionet e IFC-së MF-së; dhe

D) Palët dëshirojnë për të ndryshuar përsëri Marrëveshjen e Rishitjes së Aksioneve për të zgjatur më tej periudhën e rishitjes.

Prandaj, Palët bien dakord si më poshtë:

Seksioni 1. Përkufizime. Të gjitha termat me germa kapitale të përdorura në këtë marrëveshje ndryshimi dhe që nuk përkufizohen ndryshe në të, nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe, kanë kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Rishitjes dhe Marrëveshjen e Blerjes së Aksioneve.

Seksioni 2. Ndryshim në Marrëveshjen e Rishitjes së Aksioneve:

Seksioni 2.1 Seksioni 1.1 (Interpretimi) i Marrëveshjes së Rishitjes ndryshohet në 10 gusht 2006, dhe ndryshohet më tej nëpërmjet ndryshimit të termit të përkufizuar më poshtë:

“Periudha e shitjes është periudha që fillon në datën e transferimit dhe që përfundon më 31 dhjetor 2008.

Seksioni 3. Hyrja në fuqi. Pas ratifikimit nga Parlamenti, kjo Marrëveshje e Ndryshimit të Dytë hyn në fuqi ditën e pesëmbëdhjetë pas botimit të ligjit përkatës që e miraton këtë Marrëveshje ndryshimi në Fletoren Zyrtare. Nëse kjo Marrëveshje nuk hyn në fuqi sipas dispozitave të këtij seksioni 3, më 31 mars 2008, kjo Marrëveshje e Ndryshimit të Dytë konsiderohet e pavlefshme, përveç kur bihet dakord me shkrim ndërmjet të gjitha Palëve të saj.

Në dëshmi të kësaj, Palët kanë marrë masa për ta nënshkruar këtë Marrëveshje Ndryshimi të Dytë në emrat e tyre përkatës sipas datës së shkruar më sipër.